



MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 3663 Prot.

Tiranë, më 03. 5: 2018

Nr. Identifikimi 256

Vendimi 16

REFUZIM DEKLARATE MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Mos paisjen me Deklaratë Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Personi juridik: “Buna Mat” sh.p.k.

Nr. NIPT-i: K78619901B

Adresa e selisë: Lagjja e Re, Ndërtesë private Nr. 113, Burrel, Dibër

Personi përgjegjës: Mexhit Buna

Për të zhvilluar projektin “**Karrierë kuarci**”.

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Vendndodhja: Vendburimi “Kodra e Batrave”, Derjan, Dibër

Bazuar në pikën 2 të nenit 12 të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Drejtorive Teknike:

- *Drejtoritë teknike të ministrisë shprehin mendimin si më poshtë vijon:*
 - Rekomandojme mbajtjen parasysh të referencave ndaj ligjit të pyjeve dhe të dhenave kadastrale për pyjet dhe kullotat.
 - Mbetjet që do të gjenerohen në ndërtimin e veprës duhet të specifikohen sipas kodit të VKM nr. 99, datë 18.2.2005, “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve” të ndryshuar;

- Mbetjet teknologjike që do të gjenerohen, t'i dorëzojë sipas kërkesave të VKM nr. 371/2014 "Përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikëshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikëshme;
- Zhvilluesi duhet t'i drejtohet Njësive të Qeverisjes Vendore përkatëse, e cila bazuar në pikën 21 të VKM nr. 575, datë 24. 06. 2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"
- Duhet të bashkëlidhet në raport shkresa Kthim përgjigje nga NJ.Q.V për përcaktimin e venddepozitimitin e mbetjeve inerte, kërkesë e pikës 8 dhe 15 të vendimit të sipërpërmendur;
- Mjetet teknologjike që do të transportojnë apo transferojnë mbetjet, duhet të jenë të pajisur me licencë të tipit III.2.B, si detyrim i ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar;
- Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e Shtojcës 1 të VKM nr. 229, datë 23. 04. 2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme;
- Të respektohen kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 994, datë 02.07.2008 "Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin" të ndryshuar;

2. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:

Pasi shqyrtimit të dosjes me Nr. 33 Prot, datë: 04.01.2018 të subjektit "Stone Mondial" sh.p.k. për aktivitetin "Karrierë kuarci", me vendndodhje Vendburimi "Kodra e Batrave", Derjan, Dibër, u vendos refuzimi i kërkesës për këtë projekt, për shkak të ndikimeve të rëndësishme negative në mjedis me pasoja afatgjata, që dëmtojnë cilësinë e mjedisit dhe nuk mundësojnë përmbushjen e standardeve mjedisore përkatëse.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM


EDISON KONOMI


MINISTRI

BLENDI KLOSI

